



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 mars 2020
Nr. ref.:RK1529/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI09/19

Parashtrues

Leutrim Hajdari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në
Pejë – Dega në Klinë C. nr. 239/2017 të 6 shtatorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Leutrim Hajdari nga Klina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Bedri Gashi, avokat nga Klina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë C. nr. 239/2017 e 6 shtatorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson në kërkesë se cilat të drejta dhe liri kushtetuese ai pretendon se i janë shkelur, por kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të interpretojë dhe vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e procedurës së shkurorëzimit të iniciuar nga ana e tij, në Gjykatën Themelore në Pjesë – Dega në Klinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 24 janar 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sqarohet lidhur me shterimin e mjeteve juridike, duke iu përgjigjur pyetjes nëse ai kishte ndërmarrë ndonjë hap procedural lidhur me kërkesën e tij. Me këtë njoftim, Gjykata gjithashtu kërkoi që parashtruesi i kërkesës të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin e tij.
8. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar për përfaqësuesin ligjor, duke deklaruar se procedura në lidhje me kërkesën e tij ishte në pritje në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me numër të lëndës C. nr. 239/17.
9. Më 16 prill 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë, për regjistrimin e kërkesës dhe e ftoi atë që të paraqesë komentet e saj, nëse ka, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e shkresës së Gjykatës.
10. Më 30 prill 2019, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, paraqiti komentet e saj në lidhje me rastin numër C. nr. 239/17.

11. Më 3 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, si dhe Aktvendimin C. nr. 239/17 të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë të 6 shtatorit 2018.
12. Më 23 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi komente shtesë, si dhe Aktvendimin Ac. nr. 2656/19 të Gjykatës së Apelit të 29 korrikut 2019, me të cilin Gjykata e Apelit anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë C. nr 239/17, dhe ia ktheu të njëjtës çështjen për rigjykim.
13. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

14. Gjykata vëren se ekzistojnë dy grupe të procedurave gjyqësore në rastin konkret. Grupi i parë i procedurave ka të bëjë me një padi për zgjidhje të martesës, të vendosur me vendimin nr. 62–2018–1939 (505) të Gjykatës së Rrethit në Fier, Republika e Shqipërisë, të 12 prillit 2018; grupi i dytë i procedurave ka të bëjë me padinë për zgjidhje të martesës, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Klinë. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i paraqesë ato veçmas në këtë raport.

Procedura në lidhje me kërkesën për zgjidhje të martesës të paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Fier, Republika e Shqipërisë

15. Më 8 shtator 2017, A. D., ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, parashtroi kërkesë për zgjidhje të martesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Fier, Republika e Shqipërisë.
16. Më 12 prill 2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Fier, Republika e Shqipërisë, nxori vendimin nr. 62–2018–1939 (505), me të cilin zgjidhi martesën në mes të parashtruesit të kërkesës dhe ish-bashkëshortes së tij, e cila banon në Fier, Republika e Shqipërisë. Me po të njëjtin vendim, Gjykata vendosi që fëmija i mitur i (ish) bashkëshortëve t'i mbetej në kujdestarinë e nënës, përkatësisht ish-bashkëshortes së parashtruesit të kërkesës.
17. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës paraqit ankesë në Gjykatën e Apelit në Vlorë. Pretendimi i tij kryesor në këtë ankesë ishte se Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Fier nuk kishte kompetencë territoriale për shqyrtim dhe vendosje të çështjes në fjalë, meqë martesa ishte lidhur në Klinë – Republika e Kosovës, ku bashkëshortët e kishin pasur edhe vendbanimin e fundit të përbashkët.

Procedura në lidhje me kërkesën për zgjidhje të martesës të dorëzuar në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë

18. Më 18 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për zgjidhje të martesës në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë.

19. Nga shkresat e lëndës rezulton se në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë, lidhur me këtë çështje janë mbajtur tri seanca gjyqësore (10.01.2018, 17.04.2018, 08.06.2018).
20. Më 6 shtator 2018, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me Aktvendimin C. nr. 239/2017, ndërpreu procedurën për këtë çështje sepse konstatoi se *"janë duke u udhëhequr dy procedura për të njëjtën çështje dhe është një vendim i formës së prerë dhe është i plotfuqishëm dhe i njëjti është atakuar nga pala paditëse dhe kjo do të jetë për të dy palët më e arsyeshme që të skjarohen çështjet rreth kësaj procedure. Në pajtim me këtë, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë e ndërpreu këtë procedurë "derisa te zgjidhet çështja paraprake lidhur me njohjen e aktgjykimit të Republikës së Shqipërisë, nr. 62-2018-1939, dt.16.04.2018, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit në Fier, Republika e Shqipërisë"*.
21. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore.
22. Më 29 shtator 2019, Gjykata e Apelit, me [Aktvendimin Ac. nr. 2656/2019] miratoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë dhe ia dërgoi çështjen të njëjtës për vendosje të sërishme. Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj theksoi: *"Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se duhet ndërprerë procedura kontestimore në këtë çështje derisa të zgjidhet çështja paraprake lidhur me njohjen e aktgjykimit të Republikës së Shqipërisë [...] të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Fier. Gjykata e Apelit nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një vlerësim të tillë juridik të Gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret aktvendimi i ankimuar është përfshirë me kontradikta të theksuara [...] Gjykata e shkallës së parë një vendim të tillë e ka arsyetuar me faktin se në shkresat e lëndës ekziston një aktgjykim i Gjykatës së Rrethit në Fier, për të cilin pretendon se është bërë i plotfuqishëm dhe i njëjti është atakuar nga tani paditësi. Megjithatë një vendim gjyqësor i atakuar nuk mund të bëhet i plotfuqishëm përderisa lidhur me ankesën e parashtruar nuk është vendosur në instanca tjera. Për më tepër, në arsyetimin e aktvendimit të atakuar theksohet se ekziston një kërkesë për njohjen e këtij aktgjykimi, për të cilin duhet vendosur. Megjithatë, në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilin do të vërtetohej se ekziston një kërkesë e tillë [...] Fakti nëse lidhur me çështjen e ngritur është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër gjyqësore, apo eventualisht ekziston ndonjë vendim i formës së prerë, nuk paraqet bazë për ndërprerjen e procedurës nga gjykata e shkallës së parë, por faktet e tilla do t'i mundësonin gjykatës që të konstatojë ekzistimin e litispëndencës (gjyqvarësisë), respektivisht konstatimin e faktit nëse bëhet fjalë për çështje të gjykuar, me ç'rast eventualisht do të mund të plotësoheshin kushtet për hedhjen e padisë, por assesi për ndërprerjen e procedurës [...] Gjykata e Apelit nuk mund ta vlerësojë nëse janë plotësuar kushtet për ndërprerjen e procedurës kontestimore për arsytet të cilat gjykata e shkallës së parë i ka nënvizuar, andaj edhe rrjedhimisht vlerëson se aktvendimi i atakuar duhet të anulohet, dhe çështja të kthehet në procedim të sërishëm"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës nuk ka deklaruar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon të jenë shkelur me aktgjykimin e kontestuar.
24. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që “të vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e procedurave të shkurorëzimit që janë iniciuar me padinë e tij në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë [...] dhe që janë ndërprerë pa bazë ligjore, pas mbajtjes së tri seancave.
25. Parashtruesi pretendon si në vijim: *“kemi dy veprime të paligjshme nga këto gjykata, të dyja Gjykata Klinë - Kosovë, që e ka ndalur procedurën, dhe Gjykatës së Fier të Shqipërisë, që ka vendosur për shkurorëzimin”*.
26. Më tej, parashtruesi i kërkesës deklaron se *“për shkurorëzimin e bashkëshortëve, me vendbanim dhe shtetas të Kosovës, ka vendosur për shkurorëzim një gjykatë pa të drejtë dhe jokompetente e një shteti tjetër siç është Gjykata e Rrethit të Fierit– Republika e Shqipërisë[...] Gjyqtarja e qështjes, E. L., pa praninë e palës-burrit, Leutrim Hajdari, me një vendim prej 11 faqesh, për pranimin e kërkesëpadisë për shkurorëzim të A. H., [...] përveq tjerash edhe fëmiu i besohet paditëses, si nënë e fëmiut.”*
27. Parashtruesi më tutje vë në dukje se, sipas udhëzimeve të gjyqtarit të qështjes në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Klinë, ai ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Vlorë, kundër vendimit të Gjykatës së shkallës së parë në Fier, por edhe pas gjashtë muajsh nga koha kur është bërë ankesa, Gjykata e Apelit në Vlorë nuk ka marrë kurrfarë vendimi.
28. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata *“që të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së qështjes së paraqitur në ankesë”*.

Komente të paraqitura nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë

29. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit, në përgjigjen e saj, Gjykata Themelore në Pejë –Dega në Klinë, ndër të tjera, sqaroi si në vijim:

“është vërtetuar nga e paditura dhe e autorizuar e saj, ku paralelisht janë duke u zhvilluar dy procedura për të njëjtën qështje dhe e paditura Gjykatës ja ka sjellë një vendim me nr 62-2018-1939 (505) i datës 12.04.18 i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 12.05.2018, lëshuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor në Fier nga gjyqtarja Ejona Lazellari. Pasiqë e autorizuar e të paditurës ka propozuar që kjo qështje të ndërpritet, pasi që aktvendimi në fjalë është atakuar nga pala paditëse me ankesë e ushtruar nga paditësi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Vlorë e cila mban datën 07.05.2018 . E paditura ka dorëzuar Aktvendimin e cekur me lart e lëshuar nga Gjykata e rrethit Fier për njohjen e tij, pranë kësaj Gjykate, mirëpo meqë paditësi ka dorëzuar ankesën dhe e njëjta është e afatshme ku në këtë rast i është refuzuar kërkesa për njohjen e aktgjykimit të huaj. Nga e gjithë sa u tha më lartë Gjykata e qështjes ka ndërprerë procedurën sipas vendimit C nr 239/17 të datës 06.09.2018 deri në vendosjen e qështjes nga Gjykata e Apelit në Vlorë, pasi që në këtë rast

kemi të bëjmë me gjyqvarësi ku për të njëjtën çështje nuk mund të zhvillohen dy procedura paralelisht”.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [C. nr. 239/2017] të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, të 6 shtatorit 2018.
33. Megjithatë, Gjykata vëren se paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës gjithashtu përcakton detyrimin e shterimit të *“të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”*. Ky detyrim kushtetues është i përcaktuar edhe me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Këto të fundit përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

“[...]

2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj ”.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

“(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”.

34. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, përcaktojnë qartë detyrimin e “*shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj*”, me kusht që një kërkesë të deklarohej e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj nga Gjykata Kushtetuese.
35. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur janë të përcaktuara qartë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe janë mbështetur në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
36. Arsyeimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete juridike efektive për parandalimin, gjegjësisht korrigjimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të mekanizmit të drejtësisë kushtetuese (Shih ndër të tjera, rastet e Gjykatës nr. KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
37. Gjykata rithekson se kjo qasje kërkon që para se të drejtohen në Gjykatë Kushtetuese, parashtruesit e kërkesave kushtetuese duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, në procedura administrative ose gjyqësore, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI62/16, parashtrues *Bekë Lajçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2017, paragrafët 59-60; KI07/09, parashtrues *Demë Kurboqaj dhe Besnik Kurboqaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; KI109/15, parashtrues *Milazim Nrecaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2016, paragrafët 27-28; dhe KI148/15, parashtrues *Xhafer Selmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 prillit 2016, paragrafët 27-28).
38. Megjithatë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton edhe përjashtimet dhe kriteret mbi bazën e të cilave këto përjashtime mund të aplikohen, duke theksuar se rregulli i shterimit duhet të zbatohet me një “*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*”, duke pasur parasysh sfondin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shih, në këtë kontekst, dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI84/17, parashtrues *Bahri Maxhuni*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 majit 2018, paragrafët 25, 26 dhe 27).
39. Një ndër këto përjashtime sipas praktikës së GJEDNJ-së, është mos detyrimi që individët, në parim, t’i shterojnë mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme që i kanë në dispozicion (shih, në këtë kontekst, rastin e

GJEDNJ-së, *Cinar kundër Turqisë*, vendimi 13 nëntorit 2013 dhe *Prystavka kundër Ukrainës*, aktgjykim i 17 dhjetorit 2002; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019, I. Bazat Procedurale të Papranueshmërisë, A. Mos-shterimi i mjeteve juridike, 2. Aplikimi i këtij Rregulli, e. Ekzistenca dhe Përshtatshmëria, paragrafi 77).

40. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, pasi ishte njoftuar me përmbajtjen e aktvendimit C. nr. 239/2017 të Gjykatës Themelore, të 6 shtatorit 2018, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila më 29 shtator 2019 [me Aktvendimin Ac. nr. 2656/2019], miratoi si të bazuar ankesën e tij, anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe e ktheu atë për rigjykim. Rrjedhimisht, rezulton se procedura pranë Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë ende nuk ka përfunduar.
41. Gjykata tashmë ka përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013; KI32/11, parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 prillit 2012; KI113/12, parashtrues *Haki Gjocaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2013, paragrafi 34; KI114/12, parashtrues *Kastriot Hasi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
42. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e detyruar që kërkesën e parashtruesit ta shpallë të papranueshme si të parakohshme, gjegjësisht për arsye se nuk janë shteruar mjetet juridike efektive në rastin e tij.
43. Rrjedhimisht, kërkesa shpallet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej përmes pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 5 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi